



VENDIM

Nr. 93 Datë 16.07.2012

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës __.07.2012, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorive Teknike për disa ndryshime në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike,

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike. (Ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi me datë 1 gusht 2012 dhe do të shtrijë efektet e tij deri në fund të vitit 2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.93 Datë 16.07.2012

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Sokol Ramadani	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____



Teksti i ndryshimeve

Ndryshimet ne Rregullat e Tregut te Energjisë Elektrike miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionerëve nr. 93 date 16.07.2012

A).Ne kapitullin IX pika 1.3 behen keto ndryshime:

IX.1.3 a. Çmimi i Energjisë Balancuese llogaritet për çdo muaj me çmimin maksimal të blerjes të energjisë elektrike ne tregun e parregulluar nga KESH sh.a plus 10% te këtij çmimi ose ne mungese te tij me çmimin e blerjes se energjisë elektrike nga FPSH-ja prej Prodhuesve te Vegjël, HEC-eve te rinj konçesionar, miratuar nga ERE plus 20 % te këtij çmimi, për disbalancat negative.

IX.1.3 b – OST sh.a çdo ditë do të bëjë shumën aritmetike të 24 orëve të disbalancave negative të shkaktuara nga çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike dhe çdo muaj do të përgatisë faturën mujore si shumë aritmetike e çdo 24 orëve të disbalancave negative dhe do ti dërgojë pjesëmarrësve të tregut faturat përkatëse.

OST sh.a do të bëjë shumën aritmetike të 24 orëve të disbalancave pozitive të shkaktuara nga çdo pjesëmarrës tregu i energjisë elektrike dhe çdo muaj do të përgatisë faturën mujore si shumë aritmetike e çdo 24 orëve të disbalancave pozitive të cilat do të jenë me çmimin e Gjenerimit Publik dhe do ti dërgoj pjesëmarrësve të tregut faturat përkatëse. OST /Operatori i Tregut njofton pjesëmarrësit e tregut për disbalancat e tyre për ditën paraardhëse brenda orës 12:00 te ditës pasardhëse.

IX.1.3.c, CEZ Shpërndarje sh.a në funksionet e tij si Operator i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik me Pakicë, do të jetë subjekt i disbalancave sipas dispozitave të mësipërme si për disbalancat pozitive ashtu edhe për ato negative. Të gjithë gjeneruesit publik dhe jo publik do të jenë objekt i disbalancave sipas dispozitës së më sipërme.

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes disbalancat do të llogariten me matje. (aparaturat matës).

IX.1.3.d). Brenda datës 5 të muajit n+1, KESH i dërgon OST çmimin mesatar të ponderuar të importeve të energjisë elektrike të realizuar prej tij për muajin n. OST sh.a brenda datës 10 të muajit n+1 u dërgon faturat pjesëmarrësve të tregut. Në llogaritjen e pagesave OST sh.a do të përdor kursin mesatar të këmbimit të Euro/leke të muajit n të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

HEC-et e Vegjël të lidhur në rrjetin e shpërndarjes nuk do të jenë subjekt i trajtimit nga disbalancat deri deri në fund të vitit 2012

IX.1.3.e, Disbalancat brenda kufirit +/- 5% do të kompensohen në natyrë në bazë në javën pas operimit.

B) Në Shtojcën A, Terma dhe Perkufizime paragrafi 2, termi Disbalanca ndryshon dhe behet:

Disbalanca është diferenca midis fluksit të energjisë të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe (p.sh., nominimi fizik i programit) dhe fluksit aktual të matur të energjisë, për një orë të caktuar.

Një gjenerator është në balancë kur gjenerimi i tij i matur është i barabartë me sasinë e programuar të livrimit të kontraktuar, në një orë të caktuar.

Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është në balancë kur konsumi i tij i matur përputhet me kërkesën e tij të kontraktuar

Një gjenerator është *ne disbalance negative* kur gjenerimi i tij i matur është më i vogël se livrimi i tij i kontraktuar

Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është *ne disbalance negative* kur konsumi i tij i matur është më i madh se kërkesa e tij e kontraktuar

Një gjenerator është *ne disbalance pozitive* kur gjenerimi i tij i matur është më i madh se livrimi i tij i kontraktuar

Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është *ne disbalance pozitive* kur konsumi i tij i matur është më i vogël se kërkesa e tij e kontraktuar.

Keto ndryshime hyjnë në fuqi me datë 1 gusht 2012 dhe do të shtrijnë efektet deri në fund të vitit 2012.